



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

Zyra e Çështjeve Politike dhe Marrëdhënieve me Publikun

**FJALIMI I KRYETARIT TË PREZENCËS NË SEANCËN PLENARE TË
KONSORCIUMIT NDËRKOMBËTAR
TIRANA INTERNATIONAL HOTEL, 19 PRILL 2011**

Ministër Nishani, Ministër në detyrë Peka, Prokurore e Përgjithshme Rama, Ambasador Sequi, Ambasador Arvizu, të nderuar miq, zonja dhe zotërinj, mirëmëngjesi!

Kam kënaqësinë të mbaj këtë fjalë sot në mbledhjen vjetore plenare të Konsorciumit Ndërkombëtar.

Më lejoni të lavdëroj të gjithë ata individë aktivë nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë përgatitur Konsorciumin Ndërkombëtar edhe për një vit tjetër të suksesshëm.

Të nderuar miq dhe kolegë, meqë ka kaluar rreth një vit nga hera e fundit që jemi mbledhur, do të tregohesha neglizhent po të mos përmendja çështjen e rëndësishme të liberalizimit të vizave dhe të festojmë faktin që qytetarët shqiptarë mund të lëvizin tashmë të lirë në vendet e Bashkimit Evropian.

Megjithatë, siç e dini, liberalizimi i vizave nuk ndodhi rastësisht, por erdhi, kryesisht, si rezultat i përpjekjeve të Ministrisë të Brendshme dhe veçanërisht përpjekjeve të Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kufirit dhe Emigracionit.

Kolegë, ndërsa trajtojmë temën e seancës së këtij viti “Adresimi i Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian për Shqipërinë”, do të doja të ngrija disa çështje, që besoj se janë me rëndësi thelbësore për diskutimet tona.

Së pari, në luftën kundër krimit të organizuar, duke pasur parasysh se ku qëndronte vetëm pesë vite më parë Departamenti i Hetimit të Krimeve, mendoj se është me vend të them se tashmë ata ndodhen në një pozicion shumë më të fuqishëm për të luftuar krimin e organizuar në krahasim se më parë.

Me futjen në përdorim të MEMEX-it (sistem IT që u ofron organeve të zbatimit të ligjit, të cilat kërkojnë dhe shkëmbejnë informacione kriminale, zgjidhje për menaxhimin e informacioneve në përgjithësi dhe atyre kriminale në veçanti) me përmirësimin e praktikave të policimit të fshehtë dhe me zbatimin e planeve përkatëse të veprimit, mund të themi se Departamenti po i afrohet standardeve të BE-së.

Megjithatë, puna e laboratorit të ADN-së duhet përmirësuar.

Duhet zhvilluar trajnime të personelit të laboratorit dhe prokurorëve, si dhe të punohet për certifikimin e laboratorit.

Aktualisht, prokurorët nuk kanë njohuritë e mjaftueshme sesi të paraqesin provat nga testi i ADN-së apo si të ndërtojnë një çështje në bazë të të dhënave të ADN-së.

Nevojitet trajnim edhe për punonjësit e sistemit gjyqësor për të interpretuar provat nga testi i ADN-së në mënyrë më të saktë.

Për më tepër, nevojitet shumë edhe një sistem për menaxhimin e çështjeve në gjykatë.

Mund të shtoj madje se ndoshta edhe policia ka nevojë për një asistencë të tillë, në kuptimin që i duhet një sistem për ndjekjen e një çështje që nga fillimi i identifikimit të një veprë të mundshme penale deri në mbylljen e çështjes.

Nëpërmjet një sistemi të tillë, policia do të ishte në gjendje të analizojnë se ku ka humbur një çështje dhe për cilat arsye – duke rritur kështu numrin e krimeve të zgjidhura.

Së dyti: çështja e imunitetit nga ndjekja penale e deputetëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë.

Duke përgëzuar Kuvendin për përpjekjet për të kufizuar imunitetin e deputetëve, në lidhje me disa lloje veprash penale, mendoj se këto kufizime duhen bërë duke ndryshuar Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës.

Deklaratat vullnetare për heqjen e imunitetit, edhe pse janë për t'u lavdëruar, nuk mjaftojnë.

Së treti, në dy vitet e fundit është vënë re rritja e qëndrueshme e shërbimit të ri të provës, jo vetëm në numrin e personelit, por edhe në numrin e zyrave rajonale.

Problemet kryesore që ky shërbim has janë mungesa e hapësirave në zyrë, pajisjeve dhe trajnimeve dhe punonjësve të shërbimit të provës u mungojnë aftësitë bazë profesionale kur fillojnë punën.

Së katërti, procedurat civile duhen përmirësuar, në mënyrë që të sigurohet një shërbim më i mirë ndaj publikut të gjerë.

Më shqetësuese mbetet çështja e kohëzgjatjes së procedimeve gjyqësore, njoftimi i të gjitha palëve të interesuara, arsyetimi ligjor i vendimeve të marra dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Pra, tashmë nevojiten ndryshime si në legjislacion, ashtu dhe në praktikë.

Shqyrtimi gjyqësor i vendimeve administrative vazhdon të bëhet nga sistemi i zakonshëm i gjykatave, që shpesh është joefikas, në mënyrë të panevojshme.

Miratimi i projektligjit për ngritjen e gjykatës administrative ka mbetur pezull në Kuvend për pothuajse dy vjet, sepse kërkon miratim nga një shumicë e cilësuar.

I nxisim autoritetet shqiptare të përditësojnë projektligjin në përputhje me sugjerimet e komunitetit ndërkombëtar dhe ta miratojnë ligjin pa vonesa të mëtejshme.

Së pesti, ka ende vend për forcim të mëtejshëm të pavarësisë së gjyqësorit, duke përmirësuar procedurat e emërimit, transferimit dhe procedimeve disiplinore të gjyqtarëve.

Për sa i përket vonesës në zëvendësimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, mandatet e të cilëve kanë mbaruar, duhen gjetur mekanizmat e duhura për të siguruar emërimin e gjyqtarëve të rinj pa vonesë – përfshi këtu edhe ndryshime të legjislacionit për të parandaluar ndërprerje të tilla në të ardhmen.

Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë e Gjyqësorit, të bëra nga ODIHR-i në qershor të vitit 2010, përmbajnë disa sugjerime të spikatura për përmirësimin e situatës.

Së gjashti, pavarësisht zhvillimeve pozitive në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, sistemit gjyqësor për të miturit i mungon ende një sistem i duhur për masat rehabilituese të fëmijëve që kanë probleme me ligjin, veçanërisht për ata fëmijë që nuk kanë arritur moshën për të qenë përgjegjës për veprat penale.

Së shtati, procesi legjislativ shpesh karakterizohet nga fakti që nuk kryhen kërkime të mjaftueshme përpara fazës së hartimit, nga mungesa e transparencës dhe konsultimeve të mjaftueshme gjatë fazës së hartimit, si dhe nga mungesa e cilësisë së duhur të shkrimeve ligjore.

Në këtë mënyrë, ligjet e pasakta krijojnë probleme të shumta gjatë zbatimit të tyre.

Përmirësimi i procesit do të kishte ndikim pozitiv në cilësinë e ligjeve të miratuara dhe do të ndihmonte në parandalimin e problemeve që lindin gjatë zbatimit të tyre.

Së teti, Avokati i Popullit është një mbrojtës i rëndësishëm i të gjithë qytetarëve shqiptarë nga shkelja e të drejta të tyre nga ana e organeve shtetërore të administratës publike.

Për këtë arsye, vonesa në vijimësi në zgjedhjen e Avokatit të Popullit, që duhet të kishte ndodhur në shkurt të vitit të shkuar, shkakton shqetësim të thellë.

Ligji përcakton se Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda një muaji nga mbarimi i mandatit të Avokatit të mëparshëm të Popullit. Ky afat ka kohë që ka kaluar.

Në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe të luftës ndaj diskriminimit, vitin e kaluar u miratua Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe u ngrit institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pa dyshim, ky është një zhvillim shumë pozitiv. Ai bën përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian në një fushë të rëndësishme dhe, nëse zbatohet drejt, mund të forcojë parimin e barazisë në shoqërinë shqiptare.

Gjithsesi, ka ende punë për të bërë. Për shembull, Zyra e Komisionerit ka ende nevojë të punësojë personel plotësisht të kualifikuar.

Megjithëse situata e të drejtave të njeriut është dukshëm jo aq problematike sa në vitet e shkuara, është e nevojshme që t'u kushtohet më shumë vëmendje grupeve të marginalizuara të pakicave, si për shembull romëve.

Incidenti i dhunshëm ndaj disa dhjetëra familjeve romë në Tiranë, muajin e shkuar, qe një episod shumë i shëmtuar.

Unë kam besim se, me dëshirën e mirë dhe përpjekjet e të gjitha autoriteteve kombëtare përkatëse, episode të tilla nuk do të përsëriten më.

Në fund, **së nënti**, në fushën e anti-trafikimit, Shqipëria ka bërë përpjekje domethënëse në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe në mbrojtjen e personave të trafikuar.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e ka rritur në vijimësi profilin e saj në koordinimin e përgjithshëm në këtë sektor.

Gjithsesi, Shqipëria përballet me një sërë sfidash.

Lidhur me çështjen e trafikimit të brendshëm dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë, ekziston nevoja të rritet ndërgjegjësimi i agjencive shtetërore përgjegjëse rreth këtyre prirjeve dhe të forcohet hetimi i krimeve të trafikimit dhe shfrytëzimit për punë.

Po ashtu, të drejtat e personave të trafikuar, duke filluar që nga njohja e statusit të viktimës, kompensimi i dëmeve e deri tek ri-integrimi afatgjatë, duhet të jenë çështje për t'u trajtuar me përparësi, si në legjislacion, ashtu edhe në praktikë.

Strehët për viktimat e trafikimit po vazhdojnë të bëjnë një punë të jashtëzakonshme në ofrimin e një game të gjerë shërbimesh ndihmëse për personat e trafikuar.

Kolegë, unë uroj që në këtë mbledhje vjetore plenare të ketë diskutime konstruktive dhe po ashtu, u uroj sukses partnerëve tanë shqiptarë përgjatë këtij viti.

Faleminderit!

FUND